

Secom Service SRL Branch Albania- DSHH

Pasqyrat Financiare

Për ushtrimin e mbyllur më
31 Dhjetor 2020

NIPT L82305001T

Njesia Bashkiake nr.5
Tirane

PERMBAJTJA:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)	
PASQYRA E PERFORMANCËS	
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	7
2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare	7
3. Politikat kontabël	8
5. Mjete monetare	13
6. Llogari të arkëtueshme tregtare	13
7. Kërkesa të arkëtueshme nga palet e lidhura	14
8. Të tjera llogari të arkëtueshme	14
9. Aktivitet afatgjatë materiale	14
10. Llogari të pagueshme tregtare	15
11. Detyrime tatimore	15
12. Të ardhura të shtyra	15
13. Të tjera detyrime	15
14. Kapitali	15
15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16
16. Lënde e pare, materiale të konsumueshme dhe të tjera shërbime	16
17. Shpenzime për personelin	16
19. Tatimi mbi fitimin	17
20. Angazhime dhe pasiguri	17
21. Ngjarje pas dates së bilancit	17

Secom Service SRL Branch Albania –Degë e Shoqërisë së Huaj
 PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)
 Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 (Vlerat në leke)

AKTIVET	Note	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Aktivët Afatshkurtra			
Mjete monetare	5	229,500	53,701
Llogari të arketueshme tregtare	6	0	11,479,875
Llogari të arketueshme nga palet e lidhura	7	71,355,195	96,330,291
Te tjera llogari të arketueshme	8	902,883	634,608
Shpenzime të shtyra			
Total Aktive afatshkurtra		72,487,578	108,498,476
Aktivët Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9		
Aktivët afatgjata jomateriale			
Totali për Aktivët Afatgjata			
Totali i Aktiveve		72,487,578	108,498,476
DETYRIMET			
Detyrimet Afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	3,897,045	33,367,980
Llogari të pagueshme ndaj paleve të lidhura			
Detyrimet tatimore	11	234,551	11,109,555
Te ardhura të shtyra	12	0	0
Te tjera detyrime	13	2,695,051	2,228,220
Totali për Detyrimet Afatshkurtra		6,826,646	46,705,755
Detyrimet Afatgjata			
Llogari të pagueshme ndaj paleve të lidhura			
Provizione		0	-
Totali për Detyrimet Afatgjata		0	0
Totali i detyrimeve		6,826,646	46,705,755
KAPITALI			
Kapitali I nenshkruar	14		
Rezerva ligjore			
Rezerva të tjera			
Fitimet e pashperndara		61,792,722	-1,140,288
Fitimi/Humbja e vitit financiar		3,868,211	62,933,009
Totali për Kapitalin		65,660,932	61,792,721
Totali i Detyrimeve dhe i Kapitalit		72,487,578	108,498,476

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020, u aprovuan nga Mmë 11.03.2021 dhe u nenshkrua si më poshte:



Secom Service SRL Branch Albania –Degë e Shoqërisë së Huaj
 PASQYRA E PERFORMANCES (Te ardhura shpenzime)
 Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 (Vlerat në lekë)

Pasqyra e Performancës
(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)
Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas Natyrës

	Note	Vit I mbyllur me 31 dhjetor 2020	Vit I mbyllur me 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	6,044,339	124,926,619
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	16	-1,618,995	-38,904,759
<i>1. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>			
<i>2. Të tjera shpenzime</i>	-	1,618,995	- 38,904,759
Shpenzime të personelit	17	-1,327,209	-9,634,727
<i>1. Paga dhe shpërblime</i>		-1,159,242	-8,315,287
<i>2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		-167,967	-1,319,440
Shpenzime konsumi dhe amortizimi Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale Shpenzime të tjera shfrytëzimi	9	0	0
Te ardhura/ Shpenzime financiare	18	988,076	- 2,385,379
<i>1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme</i>			- 32,752
<i>2. Shpenzime /Te ardhura të tjera financiare</i>		988,076	- 2,352,627
Fitimi/Humbja para tatimit		4,086,211	74,001,755
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19	-218,001	-11,068,746
<i>1. Shpenzimi i tatimit fitimit të periudhës</i>		-218,001	-11,068,746
Fitimi/Humbja e vitit		3,868,211	62,933,009
Fitimi/Humbja për:			
<i>Pronarët e njësisë ekonomike mëmë</i>			
<i>Interesat jo-kontrolluese</i>			

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020, u aprovuan nga Marco Negri më 29.03.2021 dhe u nenshkrua si me poshte:

Administrator
 Marco Negri
Secom Service Srl Branch Albania
 Degë e Shoqërisë së Huaj
NIPT: L 82305001 T
 TIRANA - ALBANIA

Secom Service SRL Branch Albania –Degë e Shoqërisë së Huaj
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO
Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 (Vlerat ne lëke)

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto
Per Vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019			-1,140,287		-1,140,287
Fitimi / Humbja e vitit				62,933,009	62,933,009
Levizje permes kapitalit			1,140,287	-1,140,287	0
Dividendë të paguar					0
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019			-	61,792,722	61,792,722
Fitimi / Humbja e vitit				3,868,211	3,868,211
Levizje permes kapitalit			61,792,722	-61,792,722	-
Dividendë të paguar					-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020			61,792,722	3,868,211	65,660,932

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020, u aprovuan nga Marco Negri me 29.03.2021 dhe u nënshkrua si me poshte:

Administratori



Secom Service SRL Branch Albania – Degë e Shoqërisë së Huaj
PASQYRA E LEVIZJES SE FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE (CASH FLOW)
Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 (Vlerat në lekë)

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE
 Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit		
Fitim / Humbja e vitit	3,868,211	62,933,009
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>		
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar</i>		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		
<i>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</i>		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	36,186,697	-106,900,779
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	-39,879,109	43,739,033
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	175,799	-228,737
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e investimit		
<i>a. Para të përdorura për blerjen e fillaleve</i>		
<i>b. Para të arkëtuara nga shitja e fillaleve</i>		
<i>c. Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>d. Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>e. Pagesa për blerjen e investimeve të tjera</i>		
<i>f. Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>		
<i>g. Dividentë të arkëtuara</i>		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e investimit		
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e financimit		
<i>a. Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>		
<i>b. Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
<i>c. Hua të arkëtuara</i>		
<i>d. Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>		
<i>e. Riblerje e aksioneve të veta</i>		
<i>f. Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
<i>g. Pagesa e huave</i>		
<i>h. Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare</i>		
<i>i. Interes i paguar</i>		
<i>j. Dividendë të paguar</i>		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e financimit		
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	175,799	-228,737
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 Janar	53,701	282,438
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	229,500	53,701

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u aprovuan nga Marco Negri më 29.03.2021 dhe u nënshkrua si me poshte:

Administratori
 Margó Negri



1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

“Secom Service Srl Branch Albania” D.SH.H. (shoqëria) është krijuar juridikisht në Tiranë e regjistruar pranë QKB, me datë 05.11.2018 si Degë e Shoqërisë së Huaj Secom Service Srl. Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është: Veprimtari e instalimit të tubacioneve dhe saldimit pranë kantierëve.

Administrator i shoqërisë është Z.Marco Negri

Selia e shoqërisë është Rruga Sami Frasheri, Pallati Perxhola, Kati i 1, Tiranë.

Shoqëria është e regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me NUIS: L82305001T.

Numri i punonjesve me dt 31.12.2020 është 1 dhe me dt.31.12.2019: 4

2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të Permiresuara, të cilat përbëhen nga rregullat dhe interpretimet në përputhje me Ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Në bazë të urdhrit Nr.64 datë 22.07.2014 “Per shpalljen e standarteve kombetare te kotabilitetit te permiresuara dhe zbatimin e detyrueshem te tyre”. Ministria e Financave vendosi të beje të detyrueshem zbatimin e Standarteve Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara duke filluar nga 1 Janar 2015.

Ky urdher hyri në fuqi me publikimin në fletoren Zyrtare Nr.119, datë 01.08.2014

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në kostot historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK, monedhen shqiptare, e cila është edhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë të raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur.

Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerëne detyrimet e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimivlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periud hat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar

njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Eur/LEK	123.70	121.77
USD/ LEK	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithërisht dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqëri se skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Mjete monetare dhe ekuivalentet me to maten mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Inventari

Inventarët rregjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kostopërfshihet edhe pjesa respective e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara menormën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mjete Transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyrash dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përpjestim me fazën e përfundimit të shërbimit në datën e raportimit. Faza e përfundimit të shërbimeve vlerësohet mbi ecurinë e punëve të kryera.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative. Pagesat e qirase operative njihen në pasqyrën e performancës me metodën lineare përgjate periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së përfituar njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë periudhës së qirasë.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 5% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periud hën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë. Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet shoqërore për pensione, në emër të vet dhe për punonjësit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kostot e kryera për sigurimet në emër të shoqërisë paraqiten në pasqyrën e performancës. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 akoma po evoluon në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

5. Mjete monetare

Arka, banka dhe likuiditete të tjera janë likuiditete në monedhë vendi dhe të huaj me 31 dhjetor 2020 , 2019 janë si më poshtë

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2020	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2019
Llogari ne leke	17,545	9,882
Llogari ne monedhe te huaj	211,955	43,819
Arka	-	-
Arka Valute		
	229,500	53,701

6. Llogari te arkëtueshme tregtare

Kërkesa të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020, 2019 janë si me poshtë:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2020	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2019
Kliente	-	11,479,875
	-	11,479,875

7. Kërkesa te arketueshme nga palet e lidhura

Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Detyrim ortaket	71,355,195	96,330,291
Totali	71,355,195	96,330,291

8. Te tjera llogari te arketueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
TVSH	902,883	634,608
Totali	902,883	634,608

9. Aktivet afatgjata materiale

Akivet afatgjata materiale dhe lëvizjet e tyre deri më 31 dhjetor 2020, 2019 paraqiten si më poshtë:
Aktivët afatgjata materiale

	Mjete transporti	Pajisje Zyre	Pajisje elektronike	Total
Kosto AAM				
1 Janar 2019				
Shtesa				
Pakesime/Axhustime				
31 Dhjetor 2019				
Kosto AAM				
1 Janar 2020				
Shtesa				
Pakesime/Axhustime				
31 Dhjetor 2020				
Amortizimi				
1 Janar 2019				
Amortizimi vjetor				
Rimarje amortizimi				
31 Dhjetor 2019				
Amortizimi				
1 Janar 2020				
Amortizimi vjetor				
Rimarje amortizimi				
31 Dhjetor 2020				
Vlera Neto 31 Dhjetor 2019				
Vlera Neto 31 Dhjetor 2020				

10. Llogari te pagueshme tregtare

Llogari te pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020, 2019 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Furnitore	3,897,045	30,524,603
Furnitore fatura te pamberritura	-	2,843,377
Totali	3,897,045	33,367,980

11. Detyrime tatimore

Detyrime tatimore me 31 dhjetor 2020, 2019 jane si me poshte:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Detyrime per sigurime shoqerore	16,550	40,809
Detyrime per tatime (tatim fitim)	218,001	11,068,746
Totali	234,551	11,109,555

12. Te ardhura te shtyra

Te ardhura te shtyra per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 jane:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Te ardhura te periudhave te arshme		
Totali		

13. Te tjera detyrime

Te tjera detyrime per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 jane:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Detyrime per pagat e punonjesve	41,800	41,800
Detyrim ortakët	2,650,851	2,186,420
Debitore dhe Kreditore te tjere	2,400	-
Totali	2,695,051	2,228,220

14. Kapitali

Secom Service SRL Branch Albania – Degë e Shoqërisë së Huaj , është Degë e Shoqërisë së Huaj Secom Service SRL , kështu që nuk ka kapital themeltar.

Ortaku	31 dhjetor 2020			31 dhjetor 2019		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Secom Service SRL	100	0	100%	100	0	100%
Totali	100	0	100%	100	0	100%

15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Te ardhura nga sherbimet	6,044,339	124,926,619
	6,044,339	124,926,619

16. Lënde e pare, materiale të konsumueshme dhe të tjera shërbime

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shërbime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Rimbursim shpenzime	-	734,160
Sherbime legale e fiskale	1,104,961	3,946,258
Sherbime nga te trete		27,352,647
Sherbime Noterie	22,000	37,000
Shpenzime Udhetime dhe Dieta	92,147	2,588,716
Sherbime bankare	51,586	60,786
Shpenzime te tjera per punonjesit (kurse kualifikimi)		3,861,445
Shpenzime taksa vendore dhe te tjera	74,500	67,010
Penalitete	273,801	256,736
	1,618,995	38,904,759

17. Shpenzime për personelin

Shpenzime të personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Pagat e personelit	1,159,242	8,315,287
Sigurime shoqerore	167,967	1,319,440
	1,327,209	9,634,727

18. (Shpenzime)/të ardhura financiare neto

(Shpenzime)/të ardhura financiare përfshijnë shpenzimet dhe të ardhurat nga interesi dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

Fitime humbje financiare	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Te ardhura nga interesat e fituara nga depozitat		
Te ardhura nga interesat e fituara		
Te ardhura financiare		
interesa	-	(32,752)
Fitim / Humbje neto nga kembimet valutore	988,076	(2,352,627)
Shpenzime financiare	988,076	(2,385,379)
Shpenzime financiare neto	988,076	(2,385,379)

19. Tatimi mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet më poshtë:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2020	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2019
Humbje fiskale e akumuluar		-1,140,287
Fitimi perpara tatimit	4,086,211	74,001,755
Shpenzime te pazbritshme	273,801	930,173
Fitim /humbje fiskale	4,360,013	73,791,641
Tatim fitimi I llogaritur 5%	218,001	11,068,746
Shpenzimet e pazbritëshme:		
	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2020	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2019
Gjoha dhe interesa per pagesa me vonese	273,801	256,736
Rimbursim shpenzime punonjesit	-	673,436
	273,801	930,173

20. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treat. Bazuar ne opinionin e drejtuesve te Shoqerise, konkluzioni perfundimtar ne lidhje me keto ceshtje nuk do te kete efekte negative ne pozicionin financiar te Shoqerise ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Me 31 Dhjetor 2020 Shoqeria nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

21. Ngjarje pas dates se bilancit

Nuk ka asnje ngjarje pas dates se bilancit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare

